



REPUBLICA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

DEKRET

PËR

KTHIMIN E LIGJIT NR.9531, DATË 11.05.2006
“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8410, DATË
30.09.1998 “PËR RADION DHE TELEVISIONIN PUBLIK E PRIVAT
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR””

Në mbështetje të neneve 85 dhe 93 të Kushtetutës,

Dekretoj

Kthimin për rishqyrtim edhe njëherë në Kuvend të ligjit nr.9531, datë 11.05.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””.

Nr. Dekretit 4894

Tiranë, më 06.06.2006

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
ALFRED MOISIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

Motivimi i kthimit të ligjit nr 9531, datë 11.05.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”

Të nderuar deputetë,

Duke vlerësuar, paraprakisht, punën e bërë për hartimin e ligjit nr. 9531, datë 11.05.2006, dhe rëndësinë e posacme të tij, por, me qëllim që zgjidhjet e ofruara të jenë sa më pranë standarteve që pranon Kushtetuta jonë, vendosa të mos e shpall atë, por, ta kthej edhe njëherë për rishqyrtim në Kuvend, duke besuar në mirëkuptimin dhe reflektimin tuaj që ky ligj, në përfundim të procesit legjislativ, të plotësojë aspiratën e reformimit të veprimtarisë së radios dhe televizionit publik e privat në Republikën e Shqipërisë.

Shkak parësor për kthimin e ligjit është vlerësimi që i bëj nenit 7 të tij në raport me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Sipas kësaj dispozite të ligjit, personave fizikë e juridikë, që kanë aksione në një shoqëri radio ose televizive nuk u lejohet të marrin pjesë në prokurimet me fondet publike ose shoqërive me kapital shtetëror, si dhe nuk u lejohet të marrin pjesë në procesin e privatizimit të pronës publike.

Mendoj se ky rregullim, për vlerësimin tim, cënon disa të drejta themelore kushtetuese, për ushtrimin e lirise ekonomike, barazinë e individit perpara ligjit dhe garantimit të pronës private, të sanksionuara në nenet 11, 18 dhe 41 të Kushtetutës.

Kushtetuta lejon kufizime të veprimtarisë ekonomike me ligj, por këtë vetëm për arsye të rëndësishme publike. Nga relacioni që shoqëron ligjin nuk është paraqitur asnjë arsye e këtij karakteri e cila mund të justifikonte këtë kufizim të lirive kushtetuese. Në qofte se qënia aksioner në një shoqëri radio

ose televizione do të konsiderohej si lehtësi në procesin e privatizimit apo fitimin e tenderave me fonde publike, kjo duhet të ishte rrjedhojë e një studimi konkret, i cili do t'ju shtynte juve në përfundimin se duhej penguar kjo situatë abusive. Nxjerrja e konkluzioneve apriori se media audiovizive ka përfituar në këtë proces, duke përdorur pushtetin e vet, apriori, mund të më conte dhe mua në përfundimin se edhe media e shkruar ka patur ose ka të njëjtin ndikim si ajo audiovizive. Këto përfudime apriori krijojnë pabarazi të hapur jo vetëm mes subjekteve që rregullohen në këtë ligj dhe të tjerëve, por, edhe mes subjekteve të të njëjtit lloj. Pra, me miratimin e këtij ligji, një pjesë e pronarëve dhe aksionerëve të medias lejohet të marrë pjesë në procesin e privatizimeve apo ankandeve publike, kurse pjesa tjetër jo. Mendoj se ky është një diskriminim përpara ligjit që nuk e lejon neni 18 i Kushtetutës.

Për sa më sipër dhe duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj.

Presidenti i Republikës

Alfred Moisiu

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Alfred Moisiu', written over a horizontal line.